



Njoftim Publik

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni **05nr.350/02-197584/22 dt.17.08.2022**, në emër të pronarit Gëzim, Shemësi, Remzi dhe Durim Krajkova nga Prishtina dhe Investitori "Dijari Estate" sh.a nga Vushtrria me certifikatë të biznesit ARBK 811107912, me përfaqësues Elver Zariqi nga Vushtrria, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "A" me B+P+3+Ph, Ndërtesa "B" me B+P+3+Ph dhe Ndërtesa "C" me 2B+P+3+Ph, në kuadër të Bllokut urban "ZBM-04", Tërësia "ZBm" të Planit Rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë-PZHU-së, konkretisht parcelave: nr.1332-0 dhe 1333-0 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **24.08.2022** deri me datën **07.09.2022** në Email adresën: urbanizmprihtine@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara: Ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "A" - B+P+3+Ph, Ndërtesa "B" - B+P+3+Ph & Ndërtesa "B" - 2B+P+3+Ph	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësor -"Arë e Klasës 5" – Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	0.0m' Sipas Planit rregullues "Zona Ekonomike"
c. Vija ndërtimore	5.0m' Sipas Planit rregullues "Zona Ekonomike"
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	5.0m' / 14.20m' & 5.0m' / 17.20m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 21m'/14.20m' & 24.75m'/ 14.20m' Pasme : 10.28m'/14.20m' & 14.28m'/14.20m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	Koeficienti 1.2, ose 6,818.40m², sip. ndërtimore mbi tokë
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	40%- ose S=2,074.80m² e lejuar, S=1,876.07m² e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% - ose S=2,074.80m² i lejuar dhe S=2,074.99m² propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	50% ose S=2,593.50m² lejuar dhe S=2,311.30m² - propozuar,
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	100 VP, brenda dhe jashtë ndërtesës
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet duhet të përkthyer numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zytarit _____

